

DITARI
MUJOR
**KORRIK
2023**



+42.6% më shumë
**eksporte bujqësore
në vlerë**
gjatë qershor 2023
krahasuar me qershor 2022



INSTAT: BUJQËSIA, SEKTORI QË VIJOI ZGJERIMIN E FORTË TË EKSPORTEVE

Raporti i Tregtisë së jashtme nga INSTAT tregon qartë se bujqësia shqiptare është në punë dhe vijon me sukses trendin e rritjes së eksporteve edhe gjatë muajit qershor të këtij viti, duke mbajtur vendin e parë në kontributin e rritjes së eksporteve të vendit krahasimisht me grupmallrat e tjerë, edhe pse në një periudhë sfidash nga presionet e tregjeve ndërkombëtare e kursit të këmbimit të pafavorshëm.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca tha se, "këto tregues pozitiv lidhen me politikat mbështetëse që adresojmë drejtpërdrejtë tek njerëzit e punës, fermerët tanë, duke nxitur prodhimin vendas, rritjen e cilësisë dhe të standardeve dhe qasjen e një zhvillimi të ri të zinxhirit ushqimor, përmes investimeve bashkëkohore në pikat e grumbullimit, të cilat eksportojnë prodhimet "Made in Albania" që konkurrojnë për nga cilësia e lartë në tregjet e sofistikuara të Evropës dhe më gjerë".

TASKFORCA E AKU-SË NË TERREN PËR GARANTIMIN E SIGURISË USHQIMORE



KORRIK

12 QARQË
1728 KONTROLLE
52 MASA ADMINISTRATIVE
446 PARALAJMËRIME

Vijojmë monitorimin, udhëzimin, por edhe marrjen e masave aty ku duhet për operatorët e biznesit ushqimor në të gjithë territorin e Shqipërisë përmes Task Forcës së Autoritetit Kombëtar të Ushqimit këtë sezon veror. Përveç vijës bregdetare po monitorojmë zbatimin e standardeve në çdo qark e posaçërisht aty ku ka flukse të shtuara vizitorësh.

FERMERË TË MBËSHTETUR ME NAFTË FALAS

azhbr

**SKEMA KOMBËTARE E
MBËSHTETJES 2023**

NAFTA PËR PUNIMET E MEKANIZUARA NË BUJQËSI

33,462
FERMERË TË MBËSHTETUR
ME NAFTË

DERI MË 31/07/2023

ZHVILLOHET SAMITI I OKB-SË NË ROMË PËR FUQIZIMIN E PRAKTIKAVE MË TË MIRA TË PRODHIMIT DHE TË KONSUMIT



Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca, me ftesë të homologut italian Francesco Lollobrigida, mori pjesë në panelet e nivelit të lartë të sistemeve ushqimore të Kombeve të Bashkuara zhvilluar në Romë, Itali për Sistemet e Ushqimit "UN FOOD SYSTEM SUMMIT +2", në drejtimin e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB, mes përfaqësuesve nga e gjitha bota u diskutuan për 3 ditë me radhë, ide të reja, mundësitë e bashkëpunimit dhe mbështetjen financiare, për transformimin e sistemeve të ushqimit dhe nisjen e angazhimeve të reja përmes partneriteteve, planeve të veprimit dhe mobilizimin e financave për të patur ndikim maksimal në arritjen e objektivave të OKB për zhvillimin e qendrueshëm.

STRATEGJIA 5-VJEÇARE ME BANKËN BOTËRORE, 65 MILIONË EURO PËR BUJQËSINË, KRIFCA: INVESTIME NË UJITJE-KULLIM, NDËRTIMIN E TREGJEVE E DERI TEK INOVACIONI



Strategjia e re e bashkëpunimit të Bankës Botërore me qeverinë shqiptare përbën një tjetër sinjal të fortë mbështetje që qeveria i jep bujqësisë dhe mbështet drejtpërdrejtë fermerët, agropërpunuesit dhe eksportuesit shqiptarë. Marrëveshja e arritur me Bankën Botërore do të financojë 65 milionë euro në sektorin e bujqësisë në Shqipëri për zgjerimin e rritjes të ujitjes dhe kullimit, duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ujitjen në mbi 23 mijë hektarë dhe kullimin në mbi 10 mijë hektarë.

Gjithashtu do të fuqizojmë sigurinë ushqimore, përmes rehabilitimit të infrastrukturës së laboratorëve kufitarë, në doganën e Bllatës, Kakavijës, Kaptshicës, Qafë Botës, Qafë Thanës dhe Vlorës. Investime këto që kanë një qëllim të dyfishtë: rrisin më tej sigurinë për konsumatorin shqiptar, duke kryer në kohë reale dhe me efikasitet të plotë analizat për mallrat ushqimore të importuara, përafrojnë standardet tona me ato të Bashkimit Evropian dhe lehtësojnë rritjen e eksporteve tona në mbi 80 vendet që aktualisht realizojmë shkëmbime tregtare në bujqësi e tregje të tjera të sofistikuar ku synojmë të jemi prezentë.

Falë marrëveshjes me Bankën Botërore mbështesim direkt fermerët e vegjël, duke lehtësuar daljen e prodhimit të tyre në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare, uljen e kostove të prodhimit, modernizimin e bujqësisë shqiptare, çka sjell eventualisht rritjen e konkurrueshmërisë dhe eksporteve tona.

LABORATORI "FOOD4HEALTH", MBËSHTETJE FERMERËVE E PRODHUESVE TË VEGJËL E TË MESËM



Krifca: Inkubatorë për përpunimin e peshkut dhe frutave në Vlorë dhe Korçë

Në Tricase, Itali, Ministrja Krifca vizitoi projektin e përbashkët me CIHEAM Bari, në programin ndërkufitar mes Shqipërisë, Italisë dhe Malit të Zi, për krijimin e laboratorëve të ushqimit, të cilët i vijnë në ndihmë fermerëve të vegjël e peshkatarëve për përpunimin e produkteve të tyre. Të njëjtin model suksesi po e aplikojmë në Korçë për përpunimin e fruta-perimeve dhe në Vlorë për përpunimin e peshkut. Në të dy qytetet ashtu sikurse dhe në Tricase po marrin formë dy hapësira tërësisht të reja ku fermerët të bashkuar në shoqëri të përbashkëta bujqësore, do të përpunojnë fruta-perimet dhe produktet e peshkut për të rritur vlerën e tyre dhe për të prezantuar produkte lokale të certifikuar.

LEGJISLACIONI PËR BUJQËSINË SIPAS BE-SË, KE MBËSHTETJE SHQIPËRISË NË RRUGËN DREJT INTEGRIMIT



Ekipi i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural vazhdon punën për procesin "Screening" në bashkëpunim me Komisionin Evropian, për harmonizimin e legjislacionit vendas me acquis të BE-së, duke zhvilluar një bujqësi të qëndrueshme, më afër me standartet evropiane. Gjatë korrikut u mbajtën në Bruksel takimet shpjeguese për kapitujt 11, "Bujqësia dhe Zhvillimi Rural", 12 "Siguria Ushqimore, Veterinaria dhe Politikat e Fitosanitetit" dhe 13 "Peshkimi". Komisioni Evropian shprehu mbështetjen për administratën shqiptare me qëllim forcimin e kapaciteteve dhe ftoi për propozime të mundshme gjatë takimeve bilaterale për integrimin e përsheptuar.

